



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN / MUNICIPALITY OF LIPJAN



Drejtoria i Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Datë/Datum/ Date:	07.05.2026
Për/Za/For:	z. Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit
CC:	z. Diamant Bytyqi – Nënkyetar i Komunës z. Avni Jashari - Shef i Kabinetit të Kryetarit
Nga/Od/From	z. Rexhep Rexhepi - Drejtori i Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari
Lënda/Subjecat/Subject:	Raporti për muajin Prill

I nderuar Kryetar z. Imri Ahmeti,

Të bashkangjitur gjeni Raportin mujor të aktiviteteve të Drejtoratit të Bujqësisë për periudhën nga 01.04.2026 deri me 30.04.2026

Lipjan 2026

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

SEKTORI I BUJQËSIË

Në kuadër të angazhimeve dhe aktiviteteve të Drejtoratit, gjatë muajit prill janë mbajtur takime të rregullta, ku edhe janë shqyrtuar projektet dhe aktivitetet e realizuara, si dhe janë planifikuar veprimet dhe angazhimet për periudhën në vazhdim.

Gjatë kësaj periudhe është nënshkruar anekskontrata për furnizimin me mekanizëm bujqësor, ndërsa më pas është bërë shpërndarja e pajisjeve tek fermerët përfitues të përzgjedhur nga komisioni vlerësues në kuadër të projektit për freza të traktorit dhe spërkatëse.

Po ashtu, është publikuar edhe lista tjetër pritëse për përfituesit e projektit me freza për traktor dhe spërkatëse, ku përfitues janë gjithsej 27 fermerë për freza dhe 16 fermerë për spërkatëse dhe ky mekanizëm presim që të shpërndahet gjatë mujave në vijim.

Gjithashtu, i kemi drejtuar kërkesë Ministrisë së Bujqësisë për furnizim me drunj dekorativë, bazuar në njoftimin dhe mundësinë e ofruar nga ministria, dhe jemi në pritje të realizimit të kësaj kërkesë.

Në sektorin e blegtorisë, është shpallur thirrja publike për subvencionimin e qumështit, ku fermerët përfitues do të subvencionohen me nga 0.04 € për çdo litër qumështi të dorëzuar për periudhën korrik – dhjetorë 2025.

Gjatë muajit prill kemi pranuar edhe kërkesa nga fermerët lidhur me dëmet e shkaktuara në kulturat bujqësore. Komisioni përkatës nga Drejtorati i Bujqësisë ka dalë në teren dhe ka bërë vlerësimin e dëmeve sipas rasteve të paraqitura.

Po ashtu, sipas kërkesave dhe shqetësimeve të qytetarëve, kemi vazhduar aktivitetet për trajtimin e qenve endacakë. Operatori ekonomik është duke vepruar vazhdimisht në teren dhe, pavarësisht vështirësive dhe problematikave me të cilat po përballemi, po angazhohemi maksimalisht që të ofrojmë shërbime sa më efektive për trajtimin e tyre në lagjet e Lipjanit dhe në zonat përreth.

Drejtorati i Bujqësisë do të vazhdojë me realizimin e projekteve dhe aktiviteteve të planifikuara, duke qenë në shërbim të fermerëve dhe duke kontribuar në zhvillimin e sektorit të bujqësisë në Komunën e Lipjanit.